


REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. Br. Prot. Prot No
Nr. I faq. Prot. stranica Nr. pages	Data Datum Date
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	07.05.2015
REFERENC-Ë:	DPK- DPKPP-03-03/1016/15
PËR/ZA/TO:	z. Burim ZEKAJ Udhëheqës i zyrës së Prokurimit në Trainkos sh.a
CC:	z. Gelor SHALA Kryeshef Ekzekutiv në Trainkos sh.a
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Furnizimi me Lokomotive dizel elektrike me riparim gjeneral për transport të kombinuar mallra- udhëtarë "

I nderuari z. Zekaj ,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me Tenderin " Furnizimi me Lokomotive dizel elektrike me riparim gjeneral për transport të kombinuar mallra- udhëtarë " ri-tender me numër prokurimi: TR-45008-14-008-511, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Furnizimi me Lokomotive dizel elektrike me riparim gjeneral për transport të kombinuar mallra- udhëtarë " ri-tender me numër prokurimi: TR-45008-14-008-511, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

Arsyetimi

Trainkos si Autoritet Kontraktues përmes Zyrës së Prokurimit ka iniciuar procedurën e prokurimit me titull " Furnizimi me Lokomotive dizel elektrike me riparim gjeneral për transport të kombinuar mallra- udhëtarë " ri-tender me numër prokurimi: TR-45008-14-008-511 e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së më datë 13.02.2014. Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë Procedurën e hapur, kontratë të llojit furnizim me vlerë të madhe të kontratës.

Agjencia kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar dhe trajtuar këtë procedurë të prokurimit. Gjatë shqyrtimit dhe ekzaminimit të dokumenteve në dispozicion për këtë tender, AKK ka hasur në disa kërkesa të cilat janë në kundërshtim me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës. Agjencia kundër Korrupsionit ka kërkuar dokumentacionin përkatës për këtë aktivitet të prokurimit pasi që Komisioni vlerësues ka përfunduar me procesin e vlerësimit të tenderëve. Gjatë trajtimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit të dosjes së tenderit, Agjencia ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Për këtë aktivitet të prokurimit Dosjen e Tenderit e kanë tërhequr gjithsej **12** Operator ekonomik ndërsa vetëm njëri prej tyre e ka dorëzuar ofertën për këtë kontratë.

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit të tenderëve i cili është përgatitur nga ana e Autoritetit Kontraktues, Komisioni vlerësues pas vlerësimit të ofertave ka konstatuar se ka vetëm një ofertë dhe e cila sipas Komisionit vlerësues është e përgjegjshme, pasi që i plotëson të gjitha kërkesat konform Dosjes së Tenderit. Komisioni vlerësues ka rekomanduar që fituesi i këtij tenderi të jet Operatori ekonomik i vetëm i cili ka ofertuar për këtë kontratë, pasi që ka ofruar ofertë të përgjegjshme sipas kriterëve të dhëna në Dosjen e Tenderit, andaj ka rekomanduar Zyrën e Prokurimit që të bëjë revokimin e nenit për përjashtim të kërkesës më pak se dy tender të përgjegjshëm.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit pas marrjes së rekomandimit nga ana e Komisionit vlerësues ka përgatitur Njoftimin për përjashtim të kërkesës më pak se dy tender të përgjegjshëm me të cilin e ka njoftuar Komisionin Rregullativ për Prokurimin Publik. Në arsyetimin e tij prej 3 faqesh, ndër të tjera ai ka theksuar se në të gjitha rastet kur është tenderuar gjatë tri viteve, kërkesën për dosje të tenderit e kanë bërë relativisht të njëjtit Operator ekonomik. Ofertat kryesisht kanë ardhur me çmime të njëjta dhe me dosje të njëjta. Në dy raste të tenderimit janë zbutur kriteret në mënyrë që të nxitet pjesëmarrja e sa më shumë Operatorëve ekonomik. Mirëpo prapë se prapë nuk ka rezultuar me numër më të madh të ofertave. Herën e kaluar dosjen e tenderit e kanë tërhequr 14 OE ndërsa vetëm njëri prej tyre e ka dorëzuar ofertën e që sipas Komisionit vlerësues nuk i ka plotësuar kërkesat konform Dosjes së Tenderit. Pas këtij dështimi për këtë vit prapë është ri tenderuar i njëjti aktivitet ku dosjen e tenderit e kanë tërhequr 12 OE ndërsa vetëm njëri prej tyre ka dorëzuar ofertën e tij e cila sipas Komisionit vlerësues është e përgjegjshme dhe me këtë ka rekomanduar dhënien e kontratës si dhe përdorimin e procedurës për revokim të nenit përkatës.

Për më tepër Zyrtari i prokurimit thekson se ri tenderimi nuk do të rezultojë në ngritjen e konkurrencës, numri të ofertave apo kualitetit të ofertuesve por vetëm do të rezultojë në jo seriozitet karshi Operatorëve ekonomik dhe si rrjedhojë edhe në humbjen e besimit të Operatorëve ekonomik karshi Autoritetit Kontraktues dhe në këtë mënyrë do ta rrezikonte Operimin e trenave.

Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se një veprim i tillë nga ana e Autoritetit Kontraktues bie ndesh me Ligjin në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës nenin 32 Rregullat e Përgjithshme paragrafin 4 dhe 5. Sipas këtij neni theksohet në mënyrë decitive se nëse, gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit, pranohen më pak se dy (2) tenderë të përgjegjshëm ose, kur është e zbatueshme, kërkesa për pjesëmarrje, autoriteti kontraktues duhet të anulojë aktivitetin e prokurimit. Pavarësisht nga kërkesat e përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni kur më pak se dy tender të përgjegjshëm apo kërkesa për pjesëmarrje janë dorëzuar në përgjigje të një procedure të hapur, procedure të kufizuar apo procedure të negociuar pas publikimit të njoftimit për kontratë, me kusht që a) specifikimet e para të kontratës nuk ndryshohen b) që autoriteti kontraktues ka demonstruar që për arsye të konkurrencës shumë të kufizuar në treg për kontratën në fjalë, një procedurë e re e hapur, e kufizuar ose e negociuar pas publikimit të njoftimit për kontratë nuk do të rezultoi në ngritje të numrit të tenderëve përgjegjës, kur është e aplikueshme, kërkesat për pjesëmarrje, autoriteti kontraktues mund të anuloi këtë kërkesë. Megjithatë KRPP duhet të njoftohet nga autoriteti kontraktues përkatës brenda dy ditëve nga dita e vendimit për anulimin e kërkesës. Mirëpo pavarësisht se LPP lejon revokimin e kërkesës me më pak se dy tender të përgjegjshëm, megjithatë në rastin konkret Autoriteti Kontraktues nuk ka demonstruar se ekziston një konkurrencë shumë e kufizuar për këtë lloj furnizimi dhe fakti se gjatë zhvillimit të kësaj procedure të prokurimit ka pasur prej 12 deri në 14 Operator ekonomik të cilët e kanë tërhequr Dosjen për këtë tender, tregon shumë qartë se ka numër të mjaftueshëm të Operatorëve ekonomik të interesuar që bëjnë furnizimet e tilla. Gjithashtu fakti që ky aktivitet i prokurimit është ri tenderuar disa herë nuk mund të nënkuptohet vetëm për shkak të konkurrencës shumë të kufizuar, **por kjo mund të ndërlidhet edhe me formulimin kufizues të specifikimeve teknike dhe kërkesave tjera të vendosura në Dosjen e Tenderit.**

Tek aneksi 1 i Specifikimeve teknike të detyrueshme ndër të tjera është kërkuar që shtypja boshtore të jet maksimum **18 t**, si dhe është kërkuar historiku i eksploatimit me riparime dhe **prodhuesi i lokomotivës të dorëzohet me ofertë** kërkesa këto që kanë rezultuar si pengesa për disa Operator ekonomik dhe në këtë mënyrë i 'u është pamundësuar të dorëzojnë tender për këtë kontratë. Për më tepër në bazë të dokumenteve që posedojmë nga Kompania për Menaxhimin e rrjetit hekurudhor **Infra-Kos Sh.a.** më saktësisht në dokumentin **Ekzpozeu e Rrjetit për vitin 2015** i cili është nxjerrë nga Kompania për Menaxhimin e Rrjetit hekurudhor, konstatohet shumë qartë se shtypja boshtore e lejuar në rrjetin hekurudhor të Republikës së Kosovës është maksimum **22,5 t** ku hyn në kategorinë **D-3** e që pas funksionalizimit të tërë rrjetit hekurudhor parashihet që i tërë sistemi hekurudhor të jet i kategorisë D-3, andaj duke u bazuar në këto të dhëna zyrtare Autoritetit kontraktues nuk i lejohet të caktojë një kufizim të tillë maksimum deri

në 18 t, por duhet të veproj konform normave të lejuara në rrjetin hekurudhor të Republikës së Kosovës.

Specifikimet teknike të vendosura në këtë mënyrë favorizojnë vetëm njërin nga Operatorët ekonomik i cili ka konkurruar për këtë kontratë dhe i eliminojnë Operatorët tjerë konkurrues duke e pamundësuar ofertimin e tyre.

Autoriteti Kontraktues kërkon që të pajiset me lokomotivë të vjetër të vitit 1980 e tutje. Kjo blerje do të përbënte një rrezik të lartë për Autoritetin Kontraktues duke pasuar vjetërsinë e Lokomotivës, amortizimin e saj dhe shpenzimet për mirëmbajtje. Agjencia kundër Korrupsionit gjithashtu ka vërejtur se Vendimi për formimin e Komisionit vlerësues është propozuar nga Zyrtari i Prokurimit dhe aprovuar nga Drejtori i Departamentit të Operimeve, veprim ky i cili nuk është në pajtim me LPP-në. Sipas Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik vendimin për formim të Komisionit vlerësues është kompetent ta nxjerrë vetëm Zyrtari Kryesor administrativ i Institucionit e që në rastin tuaj do duhej që një vendim i tillë të nxirrej nga Kryeshefi Ekzekutiv i Ndërmarrjes.

Konsiderojmë se veprimet e Autoritetit Kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi, nenin 27 Dosja e Tenderit, nenin 28 Specifikimet teknike, nenin 32 Rregullat e Përgjithshme të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042; si dhe pika 8 Funksionet e Zyrtarit Kryesor administrativ.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !